

# ***Tendenca të reja në artet pamore të Kosovës***

## ***Nga narracioni në konceptualizëm***

*Shyqri Nimani\**

### ***Përmbledhje***

Artin modern e sollën në Kosovë gjatë viteve 1960-1970 brezat e parë të krijuesve shqiptarë, të cilët u diplomuan në akademitë e arteve të qendrave kryesore artistike të

ish-Jugosllavisë - Lubjanë, Zagreb dhe Beograd. Këta krijues do të hyjnë në histori si pionierë të artit modern kosovar. Disa nga këta artistë tentuan të zhvillonin stile dhe doktrina autentike. Disa të tjerë, ndërkaq, që nuk arritën të shmangnin ndikimet e pedagogëve të tyre, mbetën fatkeqësisht nën ndikimet *bejkëniane* apo *shagaliane*. **Përfaqësuesit më karakteristikë në pikturë, janë:**

**Nysret Salihmixhiqi, Muslim Mulliqi, Xhevdet Xhafa, Engjëll Berisha, Adem Kastratit, Esat Valla;**

**në skulpturë: Agim Çavdarbasha dhe Agim Rudi;**

**në grafikë: Gjelosh Gjokaj, Fatmir Krypa, Agim Salihu dhe Ymer Shaqiri;**

**në artet e aplikuara: Agush Beqiri Nuredin Loxha Simon Shiroka, Shyqri Nimani dhe Violeta Xhaferi.**

Pas viteve 1970, u shfaq *new media art* si kategori më vete. Togfjalëshi arti bashkëkohor (*contemporary art*) i referohet në përgjithësi artit që krijohet tani (*art being done now*). Karakteristikë e posaçme e artit bashkëkohor janë çështjet që shpeshherë trajtohen nën ndikimin e koncepteve që paraqesin në botën e sotme termat si p.sh. *klonimi, politika, ekonomia, seksualiteti, racat, etnitetet, të drejtat e njeriut, lufta, varfëria* etj. me një impenjim të veçantë në *performanca, instilacione* dhe *video*, duke tejkaluar kështu tërësisht kufijtë konvencionalë.

***Fjalët kyç:*** artet pamore, pikturë, skulpturë, grafikë, artet e aplikuara, trende inovative, video art, media art, modernizëm, arti bashkëkohor, surealizëm, fovizëm, kubizëm, ekspresionizëm,

---

\* Prof. Shyqri Nimani, Mr. Art., Fakulteti i Arteve, Universiteti i Prishtinës, Universiteti AAB, Republika e Kosovës, [ars\\_albanica@yahoo.com](mailto:ars_albanica@yahoo.com)

futurizëm, arti konceptual, performancë, kollazhim, instilacion, freskografi, ikonografi, akuatintë, mexotintë, bakërshkrim, akuarel.

## *Hyrje*

Në botën artistike shqiptare sot, si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri, u jepet hapësirë e pamjaftueshme numrit shumë të kufizuar të artistëve të rinj, të cilët përpiqen ta zënë ritmin e trendeve më bashkëkohore të arteve pamore.

Ndërkaq, janë me dhjetëra krijues të gjeneratës së re, si *Sislej Xhafa, Alban Nimani, Erzen Shkollolli, Rudina Xhaferi, Albert Heta, Artan Balaj* e ndonjë tjetër, të cilët, të rebeluar kundër konventave tradicionale, kanë përqafuar me devotshmëri pasionante trendet kontemporane botërore për t'iu bashkëngjitur përpjekjeve të bashkëmendimtarëve të tyre ndërkombëtarë, në krijimin e doktrinae inovative të një teknologjie dhe estetike fare të re. Ata shkollohen ose specializohen në qendrat apo institucionet më prestigjioze të metropoleve evropiane e botërore. Të vetëdijshëm për rrugën e gjatë të artit, ata kanë përqafuar thënien e drejtë, të njohur, të Balzakut: *Le hasard est le plus grand artiste!*

Kosova, ashtu sikur të gjitha trojet e tjera etnike shqiptare në Ballkan, trashëgon një thesar të pasur në fushën e arteve pamore. Ky thesar përbëhet nga artefaktet arkeologjike në arkitekturë, në prodhimtarinë e artizanateve popullore, në kostumografi, si dhe në freskografi e ikonografi mjeshtërore. Pas një periudhe disashekullore stagnimi nën sundimin osman, arti pamor shqiptar filloi të përtërihet gjatë epokës së *Rilindjes Kombëtare Shqiptare*. Mirëpo, veprimtarinë e mirëfilltë të artit modern e filluan krijuesit e shpërngulur nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia në metropolet evropiane. Disa prej tyre, të cilët nuk u kthyen më në atdhe, por vazhduan të qëndronin atje, kanë arritur suksese të dukshme si në disiplinat e tyre të mirëfillta, ashtu dhe në disiplina të tjera të arteve pamore. Në mesin e tyre shquhen sidomos *Çetin Saraçi, Ibrahim Kodra, Abedin Dino, Omer Kaleshi*. Kështu, ata u njohën drejtpërsëdrejti

me trendet inovative të artit modern në zanafillën dhe bërthamën e tij.

Siç dihet, korniza kohore e artit modern (*modern art*) përfshin periudhën nga fundshekulli XIX deri në vitet 70 të shekullit XX. Për artin modern nuk ishte më e rëndësishme që subjektet të paraqiteshin në mënyrë realiste, sepse shpikja e fotografisë e kishte bërë funksionin e tij të padobishëm. Artistët eksperimentonin me kënaqësi, duke kërkuar ide të freskëta nga natyra, nga materialet dhe nga funksionet e ndryshme të artit. Nocioni i artit modern është i afërt me atë të *modernizmit*. Tendencat e tij aspironin shtigjet drejt abstraksionit. Gjatë kësaj periudhe 80-vjeçare u zhvilluan lëvizje të shumta, të cilat pasonin shpejt njëra tjetrën me emërtimet e tyre përkatëse si: *fovizëm, kubizëm, ekspresionizëm, futurizëm, pop art, minimal art, land art, performancë art, art konceptual, fotorealizëm*. Nuk do të jetë e tepërt të përmendim këtu përfaqësuesit e tyre kryesorë si: Georges Braque, Henri Matisse, Piet Mondrian, Marc Chagal, Salvador Dali, Joan Miro, Paul Klee, Henry Moore, Alexander Calder e të tjerë.

Ndërkohë, u themeluan edhe ekspozitat konceptuale, si dhe u ndërtuan shumë muze të artit modern si: *Museum of Modern Art, San Francisco Museum of Modern Art, Tate Modern, Stedelijk Museum, Centre Georges Pompidou etj.*

## ***Përfaqësuesit më tipikë të arteve pamore kosovare***

### ***1. Piktura***

Opusi krijues i **Nysret Salihmixhiqit** përbëhet nga cikli i pandërprerë i karrierës së tij, *Loja*. Është krijues i apasionuar dhe me imagjinatë të shfrenuar qoftë kur implementon vizione subtile lineare, qoftë kur realizon vizione pikturale.

**Muslim Mulliqi** (1934-1998) pasqyron, si në vizatimet ashtu edhe në pikturat e tij, motive të ambientit të ngushtë në të cilin jetoi. Ishte Rrafshi i Dukagjinit, *Gryka e Rugovës* si oreol i qytetit të Pejës, *Çarshia e Madhe* e Gjakovës, pastaj portretet dhe figurat në gjendjen e tyre të ndryshme psikologjike, siç janë: *Hamalli, Sharraxhinjtë, Nusja dhe Vjehërra, Kulla e Junikut*. M. Mulliqi ka

dhënë një kontribut të vlershëm në themelimin e Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës dhe të Akademisë së Arteve të Universitetit të Prishtinës.

**Xhevdet Xhafa** ka kultivuar një kohë të gjatë shprehjen e tij figurative me një gjuhë ekspresive figurative me konotacion të fortë dramatik. Nga ky angazhman është krijuar cikli i tij *Autobiografia* (teknikë e kombinuar kolazhimi).

**Engjëll Berisha** është njëri ndër piktorët më të shquar të pikturës në Kosovë. Motivet e krijimeve të tij krijojnë ciklin e pandërprerë të pagëzuar *Medalionet e Prizrenit*. Ndër pikturat kryesore janë: *Lindja e Medalionit të parë, Porta Dardane, Kulla e Dukagjinit, Simbolet*. Këto motive nostalgjike burojnë nga trashëgimia kombëtare.

Motivet dhe teknika e pikturave të **Adem Kastratit** (1930-2000) janë karakteristike nga pikëpamja e shprehjes dhe specifike nga ajo e teknologjisë. Tërë opusi i tij i pasur piktural përbëhet nga cikli i gjerë i krijuar nga frymëzimet e tij dhe nga motivet e pasura etnografike shqiptare të traditës.

**Kadrush Rama** (1938- 2003) ishte krijues i preokupuar me trajtimin artistik të peizazhit, të figurës dhe të natyrës së qetë. Koloriti i tij është sensibil, pastuoz dhe me vlerë *anemike* pastelozë. Imazhet e tij pikturale paraqesin përfytyrime impresioniste. Ndër veprat kryesore veçohen: *Shëtitja, Kujtimi i qetë, Takimi*.

**Tahir Emra** është piktor me ndjenjë të spikatur pikturale, të cilën e shpreh me një ekspresionizëm sa figurativ aq edhe kubistik. Paleta e tij pikturale pasqyron kompozicione me gamë të ndjeshme koloristike. Ngjyra, trajta, struktura, drita dhe hija janë në korrelacion të harmonishëm. Ndër veprat kryesore të tij janë: *Në kolltuk, Shitësi i pulave, Sofra e përgjysmuar*.

Krijimet e **Rexhep Ferrit**, janë pasqyrime meditative. Trajta, struktura, linja dhe koloriti i reduktuar implementohen në figura dhe në ambient. Ndër punimet kryesore të këtij autori, cilësohen: *Dy figura e një pritje, Bardh e zi nga Bjeshkët e Nemuna, Tre hapa*.

Motivet qendrore të piktorit **Esat Valla** janë subjektet karakteristike të vjela nga kopshti i bukur i trashëgimisë etnografike shqiptare. Ndërkaq, implementimi vizual i këtyre imazheve realizohet nga një kënd i posaçëm vështrimi, me

kolorit të këndshëm dhe me një shprehje bashkëkohore figurative. Krijimet e tij kanë një pui të një surealizmi poetik si në trajta, ashtu dhe në ngjyra. Ndër veprat kryesore janë: *Nusja*, *Sulmi i kokëboshëve*, *Dashi*.

**Nebih Muriqi** u qaset me po të njëjtën devotshmëri si vizatimit, ashtu dhe pikturës. Shprehja e tij figurative konsiston në imagjinatën vizuale të nxitur paraprakisht nga frymëzimi i tij poetik që është disiplinë e preferuar e tij. Nga veprat kryesore të tij spikasim ciklin e vizatimeve dhe të pikturave *Shtegtimi*.

**Ibrahim Ponosheci** (1947-2008) i takon grupit të ashtuquajtur *Paleta e Dukagjinit*. Në motivet e tij pikturale gërshetohen figurat njerëzore me peizazhet që kanë një konotacion liriko-surrealist. Ato aspirojnë gjithnjë metafora kuptimplote që kanë të bëjnë me ambientin etnik. Ndër veprat kryesore të tij janë: *Poema pikturale*, *Amshueshmëria*, *Peizazh nga Dukagjini*.

**Halil Muhaxheri** i takon, gjithashtu, grupit të krijuesve të Rrafshit të Dukagjinit të pagëzuar *Paleta e Dukagjinit*, të cilët, duke qenë i njëjti brez studimor dhe pedagogjik në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, kanë sajuar dhe manifestin e tyre spontan të pikturimit. Motivët, shtjellimet koloristike dhe metaforat vizuale i kanë të përbashkëta.

Edhe **Masar Caka** (1945-2000) i takon grupit të ashtuquajtur *Paleta e Dukagjinit*. Motivët e tij pikturale të ciklit të gjatë *Tebdilet*, kanë të bëjnë me emancipimin e gruas shqiptare. Kishte një ndjeshmëri të posaçme koloristike me imagjinatë të gërshetuar impresioniste-surrealiste. Ndër veprat kryesore të tij dallohen: *E kaluara* dhe *Figura*.

Një krijues tjetër i mjedisit rural është edhe **Nimon Lokaj**, piktor i apasionuar në vjeljen e peizazheve fshatarake, të cilat i shndërron në imazhe pikturale me reduktime metaforike. Të këtilla janë *Vertikalet e njoma* (1999), pastorale të posaçme të krijuara sipas trajtimeve të tij sintetizuese, i frymëzuar nga ambienti idilik i bukurive të jashtëzakonshme të konstelacionit natyror të rrethinës së Deçanit, në atmosferën e së cilës jeton dhe krijon vetë piktori.

Krijuesi **Hajrush Fazliu**, që është në një avancim gradual cilësor, i shtjellon kompozicionet e tij pikturale duke gërshetuar objekte klasike me atmosfera koloristike të estetikës bashkëkohore.

**Isa Alimusaj** ka krijuar ciklin e gjerë të pikturave në vaj dhe në kollazhime koloristike, me stilizime specifike, të cilat e bëjnë autorin të identifikueshëm qartas.

Pikturat e **Nagib Berishës** përbëjnë kompozicione të fuqishme ekspresive me motive nga trashëgimia kulturore shqiptare.

Ndërkaq, subjekt qendror i pikturave të **Daut Berishës**, i cili jeton dhe vepron në Paris, është njeriu në korrelacion me mjedisin, si çështje e ekzistencës.

Në repertorin e tij piktorial, **Shyqri Gjurkaj** ka për objekt qendror gurin si metaforë dhe si simbol domethënës. Këtë frymëzim ai e trajton me konsekuencë vite dhe dekada me radhë. Ka kohë që jeton dhe krijon në Suedi.

**Gani Llalloshi** është një krijues i prirë të hulumtojë shtigje të reja për të gjetur mënyrën më të përshtatshme të të shprehurit personal. Vizaton, pikturon dhe kombinon duke gërshtuar teknika të ndryshme krijuese. Ka kohë të gjatë që jeton dhe krijon në Lubjanë të Sllovenisë.

**Veli Blakçori** merret me sukses, pos pikturës, edhe me karikaturë. Interesimet e tij janë përqendruar viteve të fundit edhe në skulpturë e qeramikë.

Në mesin e femrave të cilat në merren me artin figurativ në mënyrë të pandërprerë, është edhe **Miradije Ramiqi**, e cila, krahas pikturës, krijon edhe poezi.

**Eshref Qahili** është piktor, i cili preferon kompozicionin dinamik me gamë pastelozë sensitive qoftë me harmoni të ngrohtë, qoftë me atë të freskët koloristike.

**Alije Vokshi** dhe **Zake Prelvukaj** janë, gjithashtu, krijuese të apasionuara, të cilat po vazhdojnë me ngulm karrierën e tyre artistike.

**Arian Berisha** është njëri nga artistët me më perspektivë të gjeneratës së re. Shprehja e tij figurative shquhet për koloritin ekspresiv dhe trajtat dinamike.

**Agron Bytyqi** ka shfaqur afinitet të theksuar për shprehjen surrealistike të stilit salvadorian.

## 2. Skulptura

Vepra e **Agim Çavdarbashës** (1944-1999) është vëllimore dhe e një cilësie të lartë artistike me trajtesa dhe sintetizim inovativ sipas estetikës bashkëkohore. Disa vite para se të ndahej nga jeta, Çavdarbasha pati treguar vullnet të jashtëzakonshëm për ta sfiduar sëmundjen që e kishte katandisur rëndë, si dhe energji titanike për të arritur vlera të mirëfillta figurative. Ndër veprat e tij më të shquara janë: *Sfera* (mermer, 1981), *Pritja* (bronzë, 1977), *Kafaz* (mermer, 1995), *Dy forma* (dru, 1996).

**Agim Rudi** përqendrohet me devotshmëri si në skulpturë, ashtu edhe në vizatim, duke aspiruar vlera bashkëkohore figurative.

**Fatmir Hoxha** është krijues i përcaktuar kryesisht për shprehje realiste skulpturale, me ç'rast kërkimi i tipareve domethënëse psikologjike është qenësore. Në varganin e punimeve të tilla dallohet edhe imazhi monumental skulpturor i figurës së *Prof. Anton Çettës* (1984-1996).

**Aziz Islamaj** është krijues që hulumton trajta dhe struktura të pastra skulpturale, qoftë kur gdhend drurin, qoftë kur skalit granitin.

**Luan Mulliqi** është një nga skulptorët më të përkushtuar të brezit të mesëm të krijuesve kosovarë. Është krijues me një ndjenjë të hollë për plasticitetin. Shëmbëllesat e tij skulpturore përbëhen nga trajta, struktura dhe patomime gamash të ndryshme.

**Ismet Jonuzi** merret, pos skulpturës, edhe me disiplina të tjera të arteve figurative, siç janë vizatimi, piktura dhe qeramika. Shprehja e tij skulpturale paraqet tipare të rrymave dhe të trendeve bashkëkohore figurative (*Valët*, 1998).

**Adem Rusinovci** i takon gjeneratës së re të skulptorëve më të talentuar kosovarë. Preferon drurin, metalin dhe poliesterin e ngjyrosur me ngjyra komplementare intensive.

## 3. Grafika

**Gjelosh Gjokaj** është krijuesi i parë në grafikë në hapësirat mbarëshqiptare. Ai krijon me po atë devotshmëri edhe në fushat e vizatimit, grafikës dhe pikturës. Opusi i tij artistik është vëllimor dhe i një cilësie të mirë. Gjatë evoluimit krijues ka

provuar shprehje nga ekspresioni në metafizikë për të arritur në një lirizëm poetik. Ndër veprat e tij kryesore që çmohen janë: *Koka, Zogitë dhe Mërgimtarët*. Pas qëndrimit për disa vjet në Romë, Gjokaj shkoi për të jetuar dhe krijuar në Augsburg të Gjermanisë, ku gjendet edhe sot. Aktualisht, me shumë sukses i përkushtohet mediumit të pikturës.

**Fatmir Krypa** është njëri nga krijuesit më të spikatur të artit grafik në hapësirat mbarëshqiptare. Frymëzimet e tij burojnë kryesisht nga trashëgimia etnografike shqiptare. Ai shquhet edhe për pedanterinë teknologjike të ekzekutimit grafik. Ndër veprat kryesore janë: *Malësorja, Metamorfoza e kohës, Përtëritja e trungut ilir*.

**Hysni Krasniqi** kultivon në mënyrë konsekuente ciklin e vet tematik me imazhe rurale. Janë këto pamje idilike fshatarake me subjekte të ndryshme trajtimi. Veprat e tij janë: *Kallinjtë, Korrja e grurit, Xixillonjat*.

**Agim Salihu** është njëri ndër grafikistët më të spikatur bashkëkohorë në mbarë hapësirën artistike shqiptare. Ka ndjenjë të theksuar për mediumin e grafikës, sidomos për teknikat e shtypit të thellë (akuatintë dhe teknikë të kombinuar). Shprehja e tij është subtile dhe imagjinare me kërkim të vazhdueshëm inovativ. Motivi bosht i grafikave dhe vizatimeve të tij është cikli *Bjeshkët e Nemuna*.

**Shaip Çitaku** preferon teknikën e bakërshkrimit, me të cilën shtjellon me subtilitet linear kompozicione dinamike të gërshetuara me objekte gjeometrike.

Grafikat dhe asamblazhet e **Bahri Drançollit**, i cili jeton dhe vepron në Munih tani e tridhjetë vjet, kanë origjinalitet dhe shprehje të theksuar bashkëkohore.

**Karmon Fan Ferri** (1946-1992) ka lënë një vargan punimesh në grafikë, në teknikën e seriografisë, si dhe në pikturë. Imazhet e tij figurative pasqyrojnë abstraksione me struktura, trajta dhe ngjyra dinamike. Një kohë të gjatë ka jetuar dhe vepruar në Munih deri kur vdiq më 1992.

**Mikel Gjokaj**, i cili jeton dhe krijon në Romë një kohë të gjatë, e shfrytëzon mediumin grafikës me përsosmëri tekniko-teknologjike të shtypit të thellë (*Ikarus*). Ndërkaq, ai shprehet edhe në pikturë me një paletë të këndshme koloristike, sidomos



në ciklin e peizazheve të krijuara në teknikën e akuarelit të kombinuar me materiale të tjera.

**Ymer Shaqiri**, i cili që disa vjet jeton dhe krijon në mërgim, është krijues i devotshëm i mediumit të grafikës. Preferon teknikat e bakërshkrimit, të akuatintës, të gjilpërës së thatë dhe të mexotintës, me të cilat realizon motivet me proveniencë tradicionale shqiptare, siç janë: *dyert e vjetra, dorëza të farkuara metalike, porta të kullave* etj.

Nga teknikat e preferuara të **Enver Rakovicës** në grafikë, është kryesisht seriografia, në të cilën ka krijuar një cikël të suksesshëm me motive të ngritura mbi një abstraksion ekspresiv koloristik.

Karakteristikë e përgjithshme e këtyre krijuesve është aspirata e tyre në kërkim të shtigjeve, të themi, narrative, për t'u shprehur sipas sintagmës "as aq konservatore, as aq moderne, por me vlera të qëndrueshme figurative."

#### 4. Artet e aplikuara

**Simon Shiroka** (1944-1989) ka kultivuar me devotshmëri traditën e shkëlqyer të artit të filigranit shqiptar. Ndërkaq, ai ka hulumtuar edhe shtigje të reja për t'i realizuar idetë e veta, nërmjet aplikimit të teknikave të kombinuara, duke shfrytëzuar mundësitë tredimensionale dhe duke krijuar ritme magjike. Ndër veprat kryesore janë: *Lojërat popullore shqiptare, Rozeta*.

**Agush Beqiri** (1931- 2006) ishte enterieristi dhe tapiseristi më i shquar në Kosovë. Ka realizuar një numër të madh enterieresh për institucione dhe ndërmarrje të ndryshme në mbarë hapësirën kosovare. Enterieret e Beqirit shquhen për invencën krijuese, pastërtinë stilistike dhe pedantërinë e ekzekutimit arkitektonik. Janë edhe dy fusha të tjera të suksesshme të tij: hortikultura dhe tapiseria. Në të dyja këto fusha Beqiri shfrytëzon elemente thelbësore nga gurra popullore shqiptare e tekstileve.

**Nuredin Loxha** (1935-1992) ishte krijuesi më i shquar në fushën e skenografisë dhe të kostumografisë në Kosovë. Opusi i tij krijues është shumëvëllimor dhe cilësor. Tërë jetën ia kushtoi formësimit artistik të skenave dhe të kostumeve teatrore dhe

filmore si skenograf shumëvjeçar i Teatrit Kombëtar në Prishtinë. Ndër veprat kryesore të tij janë: *Besa e madhe, Golgota, Sfinga e gjallë*.

**Matej Rodiqi** jeton dhe vepron në Beograd. Pos artit të grafikës reklamuese dhe të përgatitjes së librit, merret edhe me artin e tapicerisë me sukses të madh. Ka qenë mësimdhënës i lëndës së grafikës reklamuese në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Ka fituar disa shpërblime të rëndësishme.

**Lazër Lumezi** është artist me dhunti tipike për artet e aplikuara, me devotshmëri të jashtëzakonshme për të krijuar në vazhden e traditës së pasur të trashëgimisë shqiptare në argjendari, por me një estetikë bashkëkohore sipas inovacioneve personale. Vlerësohet si njëri nga artistët më të shquar në fushën e argjendarisë në hapësirat kroate. Jeton dhe krijon në Zagreb.

**Blerim Luzha** është ndër krijuesit e rrallë shqiptarë që tërë karrierën e tij ia ka kushtuar fushës së tekstileve. Krijimet e tij në *Cikli i dezenëve* shquhen për imagjinatën e pasur të stilizimeve të motiveve florale me kolorit gamash të ngrohta e të freskëta dhe me struktura atraktive.

**Shyqri Nimani** vlerësohet si krijuesi më i spikatur i dizajnit grafik në hapësirat mbarëshqiptare. Veprat e tij spikasin për frymën krijuese, qartësinë ideore dhe ndjeshmërinë e ngjyrave (cikli japonez: *Japonia e bukur dhe unë, Geisha, Mbrojtja e natyrës*); ndërkaq, nga motivet shqiptare dhe të tjera, dallohen: *Trubaduri, Familja 117, "Elena Gjika, Ta rindërtojme Kosovën së bashku, Shën Tereza Shqiptare*. Sh.Nimani merret me sukses edhe me përkthimin e veprave të shkrimtarëve dhe poetëve të shquar botërorë, si dhe me përpilimin e monografive mbi artin shqiptar dhe botëror. Ai ka dhënë kontribut të vlershëm në themelimin e Shoqatës së Artistëve Aplikativë të Kosovës, të Akademisë së Arteve të Universitetit të Prishtinës dhe të Galerisë së Arteve të Kosovës (sipas *J. Papagjonit*).

**Violeta Xhaferi** është autore e disa projekteve kostumografike për Teatrin Kombëtar Shqiptar të Prishtinës. Ka projektuar kostume edhe për film. Viteve të fundit merret kryesisht me pikturë, në të cilat pasqyrohen ndodhitë aktuale. Ka kohë që jeton dhe krijon në Kristiansand të Norvegjisë.

## Përfundim

Pas periudhës moderne, arti është transformuar me një shkallë të gjerë së bashku me ndryshimet ekonomike, globale, politike dhe sociokulturore. Shumë kufij të traditave artistike të popujve të ndryshëm janë duke humbur për shkak të shpejtësisë së transferimit të ideve, parave dhe informatave. Zhvillimi i artit bashkëkohor po kontrollohet dhe po drejtohet nga bienalet e mëdha ndërkombëtare të Venedikut, të Sao-Palos, të Whitneyt, të Kwan Jusë, të Havanës, apo edhe të Trienalit Echigo-Tsumari. Ndërkaq, ekspozita më e rëndësishme me reputacion botëror është *Documenta* në Kassel të Gjermanisë. Por, arti bashkëkohor nuk duhet të ngatërrohet me artin modern ndonëse trendet dhe lëvizjet e përvojës bashkëkohore mund t'i referohen pikërisht modernizmit.

Viteve të fundit në Kosovë, sidomos pas Luftës së fundit (1999), interesimi për trendet më bashkëkohore dhe sfidat për t'iu qasur atyre janë të dukshme. Për këtë qëllim janë themeluar edhe disa institucione të rëndësishme për informimin, trajnimin dhe kultivimin e ideve inovative konceptuale, si Qendra e Artit *ARTC* (*Art Resource and Training Center*) me donacione të Fondacionit Amerikan *SOROS* dhe të atij *Olof Palme* të Stokholmit. Devotshmëria dhe prijet e tyre inventive janë inkurajuese.

Mirëpo, për të krijuar në pajtim me manifestin e një lëvizjeje avangarde, siç është *arti konceptual* (conceptual art) apo, siç quhet ndryshe, *idea art*, që u kristalizua me punimet e dadaistit Marcel Duchamp, ndikimi i të cilit vazhdon edhe në shekullin tonë, duhet të ekzistojë një afinitet ndaj shtigjeve inovative me devotshmëri pasionante. Andaj, s'ka dyshim se arti konceptual, në një mjedis me nivel të tanishëm estetik, siç është ky në Kosovë, nuk vlerësohet (lexo: *nuk kuptohet*) as nga minoranca snobistike, as nga shumica dërmuese e krijuesve të arteve pamore.

Sot në botën artistike shqiptare, si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri, u jepet hapësirë e pamjaftueshme artistëve të rinj, të cilët mundohen ta zënë hapin nën ritmin e trendeve më bashkëkohore të arteve pamore.

Janë dhjetëra krijues të gjeneratës së re si *Sislej Xhafa*, *Alban Nimani*, *Erzen Shkollolli*, *Rudina Xhaferi*, *Albert Heta*, *Artan Balaj* e

ndonjë tjetër, të cilët kanë përfaquar nxitueshëm dhe me devotshmëri pasionante trendet kontemporane botërore. Ata shkollohen ose specializohen në qendrat ose institucionet më prestigjioze të metropoleve evropiane e botërore, të vetëdijshëm se rruga e artit është shumë e gjatë dhe se nuk i arrihet dot fundi. Me të vërtetë “hazardi është artisti më i madh!”

## ***Bibliografia***

- Oblikovanje u Srbiji*, ULUPUS, Beograd: 1973.  
*Jugoslovenska grafika 1950-1980*, Beograd: 1985.  
*Arti Bashkëkohor i Kosovës*, Galeria e Arteve, Prishtinë: 1988.  
*Likovna Enciklopedija Jugoslavije, 1,2*, JLZ “Miroslav Krleza”, Zagreb: 1987.  
Shyqri Nimani: *10x10 - ARS LONGA VITA BREVIS*, Prishtinë: 1994.  
Shyqri Nimani: *Katalogu i ekspozitës retrospektive 1963-2003*, Galeria e Arteve, Prishtinë: 2003.  
Nebih Muriqi: *Katalogu i ekspozitës*, Galeria e Arteve, Prishtinë: 1984.  
Blerim Luzha: *Katalogu i ekspozitës*, Galeria e Arteve, Prishtinë: 1984.  
Muslim Mulliqi: *Katalogu i ekspozitës*, Galeria e Arteve, Prishtinë: 1980.  
Monografia: Muslim Mulliqi, ASHAK, Prishtinë: 2000.  
Gjelosh Gjokaj: *Katalogu i ekspozitës*, Galeria e Arteve, Prishtinë: 2000.  
Fatmir Krypa: *Katalogu i ekspozitës*, Galeria e Arteve, Prishtinë: 1981.  
Nuredin Loxha: *Katalogu i ekspozitës*, Galeria e Arteve, Prishtinë: 1984.  
Agim Çavdarbasha: *Katalogu i ekspozitës*, Galeria e Arteve, Prishtinë: 2001.  
Monografia *Agim Çavdarbasha*, Dukagjini, Pejë: 2009.  
Engjëll Berisha: *Katalogu i ekspozitës retrospektive*, Galeria e Arteve, Prishtinë: 1983.  
*THE STORY OF ART*, by E. H. Gombrich, Phaidon, London: 1996.  
*IDEAS ON DESIGN*, Pentagramme, London: 1986.  
*GRAPHIC DESIGN NOW*, by Charlotte & Feter Fiell, Taschen, London-Los Angeles-Madrid-Paris-Tokyo: 2005.  
*MODERN PAINTING AND SCULPTURE 1880 TO PRESENT*, The Museum of Modern Art, New York: 2004.